



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GRAMSH
NJËSIA PËRGJEGJËSË E BURIMEVE NJERËZORE

Nr.3522 prot.

Gramsh më 31.08.2026

SHPLLJE PËR PLOTËSIMIN E VENDEVE TË LIRA NË
KATEGORINË E LARTË DREJTUESE
(SEKRETAR I PËRGJITHSHËM)

Lloji i diplomës "SHKENCA JURIDIKE"
Titulli minimal i diplomës "MASTER SHKENCOR"

Në zbatim të nenit 32 të Ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, si dhe të Kreut III, VIII të Vendimit nr. 118, datë 05/03/2014 "Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nivelit të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së", ndryshuar me VKM nr. 388, datë 06.05.2015 "Për disa ndryshime dhe shtesa në VKM nr.118, datë 05/03/2014", Vendimin nr. 47 datë 10.08.2026 "Për një ndryshim në Vendimin nr. 08, datë 12.02.2026 "Për miratimin e planit vjetor të pranimeve në shërbimin civil për vitin 2026", Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore në Bashkinë Gramsh shpall procedurat për plotësimin e vendit të lirë të kategorisë së lartë drejtuese nëpërmjet procedurës së ngritjes në detyrë në shërbimin civil:

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

KATEGORIA E PAGËS I-5.

Pozicioni më sipër u ofrohet nëpunësve civilë të nivelit të mesëm drejtues nëpërmjet ngritjes në detyrë dhe që plotësojnë kriteret për të njëjtën kategori!

Afati për dorëzimin e dokumentave: 30.09.2026
(brenda një periudhe 30 ditore nga momenti i shpalljes në portal)

Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionin si më sipër është:

I. QËLLIMI I PËRGJITHSHËM I POZICIONIT TË PUNËS

Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në Bashkinë e Gramshit. Ai raporton dhe jep llogari drejtpërdrejt te titullari i institucionit; përveç detyrave të veçanta të ngarkuara nga legjislacioni në fuqi, ka rol kryesor në formulimin e politikave dhe zbatimin e tyre; koordinon dhe garanton përfshirjen e kontributeve të dhëna nga një numër drejtorish, të cilat kanë lidhje midis tyre, gjatë procesit të formulimit të politikave, sipas fushës që mbulon institucioni; siguron zbatimin e vendimeve lidhur me politikën, duke ndjekur rregullisht procesin dhe duke marrë masa për zgjidhjen e problemeve; siguron zbatimin e programeve sektoriale dhe zhvillimin e mëtejshëm të tyre; siguron drejtim strategjik afatgjatë; identifikon mundësitë për reduktim të shpenzimeve, për përmirësim të politikave, programeve dhe performancës institucionale; menaxhon drejtpërsëdrejti drejtorët e drejtorive përmes procesit të raportimit dhe delegimit; menaxhon nëpunësit civilë dhe punonjësit e tjerë të institucionit; organizon punën dhe përcakton detyrat sipas njësisë kryesore administrative; siguron një klimë bashkëpunimi dhe gjithëpërfshirjeje të stafit dhe promovon zhvillimin e kapaciteteve njerëzore; është përgjegjës për ristrukturimin organizativ të institucionit; miraton përshkrimet e punës së nëpunësve të institucionit; garanton respektimin e afateve në nxjerrjen e akteve administrative; promovon iniciativë për përmirësimin e shërbimeve me publikun; përfaqëson institucionin, me autorizim të titullarit, brenda dhe jashtë vendit; kryen detyra të tjera të ngarkuara me urdhër të titullarit.

PRANIMI NË KATEGORINË E NËPUNËSVE CIVILË TË NIVELIT TË LARTË DREJTUES

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë që janë minimalisht në nivelin e mesëm drejtues dhe plotësojnë kërkesat e posaçme të procedurës.

1. KUSHTET DHE KRITERET E VEÇANTA

1.1 KRITERET E PËRGJITHSHME DHE TË VEÇANTA QË DUHET TË PLOTËSOJ KANDIDATI PËR KËTË POZICION JANË SI MË POSHTË:

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati janë:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d) të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e) të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje.
- f) ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas këtij ligji;
- g) të jetë nëpunës civil i konfirmuar minimalisht në kategorinë e mesme drejtuese (kategoria II-1),
- h) të mos ketë masë disiplinore në fuqi,

- i) të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”.

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

-Të zotërojnë diplomë të nivelit minimal “Master Shkencor” në Shkenca Juridike.

Diplomat, të cilat janë marrë jashtë vendit, duhet të jenë njohur paraprakisht pranë institucionit përgjegjës për njehsimin e diplomave, sipas legjislacionit në fuqi.

-Të kenë eksperiencë pune jo më pak se 5 vite në nivel drejtues, në administratën shtetërore dhe/ose institucione të pavarura dhe/ose institucionet e tjera të vetëqeverisjes vendore etj, pjesë e shërbimit civil.

Njohuri dhe aftësi:

- a) Aftësi për të drejtuar dhe menaxhuar veprimet e ndryshme;
- b) Aftësi komunikimi;
- c) Aftësi të drejtimit strategjik;
- ç) Ndërtim i marrëdhënieve ndërpersonale;
- d) Efektivitet;
- dh) Aftësi pune në grup;
- e) Kuptim të gjerë të kompetencave ndërsektoriale;
- ë) Njohuri mbi fenomenet sociale dhe ekonomike;
- f) Besueshmëri;
- g) Vizion;
- gj) Të qenët krijues;
- h) Integritet;
- i) Njohuri për sistemin ligjor evropian.

1.2 DOKUMENATACIONI, MENYRA DHE AFATI I DOREZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

1. Letër motivimi për aplikim në vendin vakant;
2. Jetëshkrim (CV) i plotësuar detyrimisht me të dhënat si adresë e-mail dhe adresën e saktë të vendbanimit në përputhje me dokumentin tip që e gjeni në linkun: <https://www.dap.gov.al/legjislacioni/udhëzime-manuale/60-jeteshkrimi-standard>;
3. Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën Bachelor) shoqëruar me listën e notave. Për diplomat e marra jashtë Republikës së Shqipërisë të përcillet njehsimi nga Ministria e Arsimit;
4. Dëshminë e statusit të nëpunësit civil;
5. Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
6. Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
7. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
8. Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
9. Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;

10. Vërtetim nga institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

11. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti pranë Zyrës së Protokoll-Arkivit në Bashkinë Gramsh, brenda dates 30.09.2026

1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga përfundimi i afatit të aplikimit, Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore do të bëjë verifikimin paraprak të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurim dhe në datën 12.10.2026 do të shpallë në portalin "AKPA" dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Gramsh, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta si dhe datën, vendin dhe orën ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë, kandidatët që nuk janë shpallur të kualifikuar do të njoftohen me e-mail nga Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, dhe kanë të drejtë të paraqiten pranë saj për t'u njohur me arsyet e moskualifikimit. Ata mund të ankohen brenda 5 (pesë) ditëve pune nga shpallja e listës. Njësia e Menaxhimit të Burimeve Njerëzore, do të kthejë përgjigje të arsyetuar brenda 2 (dy) ditëve pune.

1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të testohen në lidhje me:

- Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligjin nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil";
- Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin nr. 9131, datë 08.09.2003 "Për rregullat e Etikës në Administratën Publike";
- Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit";
- Ligjin nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 "Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë";
- Ligjin nr. 9632, datë 31.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar;
- Ligjin nr. 9920, dt.19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
- Ligjin nr.10 296, dt. 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin";
- Ligjin nr.93/2015 "Për Turizmin";
- Ligjin nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Legjislacionin e prokurimit publik;
- Legjislacionin mbi auditimin.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a) Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin përgjithësues të punës për pozicionin;
- b) Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c) Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën;

1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE

Vlerësimi maksimal është 100 pikë dhe përfshin pikët maksimale për secilën nga fazat e mëposhtme:

- a) vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, duke përfshirë (vlerësimin e arsimimit, eksperiencës dhe trajnimeve të lidhura me fushën, si dhe vlerësimet e arritjeve vjetore) 10 pikë;
- b) testim me shkrim, 40 pikë;
- c) intervistën e strukturuar me gojë, 50 pikë;

2. NJOFTIMI I REZULTATEVE TË KONKURIMIT

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Njësia e Burimeve Njerëzore - Bashkia Gramsh, do të shpallë në portalin “AKPA”, në faqen zyrtare dhe stendat e informimit të publikut të Bashkisë Gramsh, listën e fituesve të përbërë nga kandidatët që kanë grumbulluar mbi 70 pikë të renditur duke filluar nga ai me më shumë pikë. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së email-it).

Pa cenuar të drejtën e ankimit gjyqësor, sipas legjislacionit në fuqi, kandidatët kanë të drejtë që të ankohen me shkrim brenda 5 (pesë) ditëve nga shpallja e rezultatit. KPP-ja merr vendim brenda 5 (pesë) ditëve dhe, kur është rasti, bën korrigjimin e listës së fituesve të shpallur. Vendimi dhe kur është rasti lista e korrigjuar, shpallet menjëherë në portalin “AKPA”, në faqen zyrtare dhe në stendat e informimit të publikut të Bashkisë Gramsh.

DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT

Në përfundim të periudhës së ankimimit, Institucioni Bashkia Gramsh do të shpallë fituesin në portalin “AKPA”, në faqen zyrtare dhe në stendat e informimit të publikut të Bashkisë Gramsh. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen në mënyrë elektronike për datën e saktë të shpalljes së fituesit.